



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 1848/Prot.  
13

Tiranë, më 4.4. 2022

URDHËR

Nr. 174, Datë 4.4.2022

PËR

**HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË DOKTORATË  
NË “EKONOMI DHE TURIZËM I QËNDRUESHËM”, NË UNIVERSITETIN  
“LUIGJ GURAKUQI” SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 77 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

**URDHËROJ:**

1. Hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë “Doktoratë” në “Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm” që do të zhvillohet në gjuhën shqipe.  
Studimet e doktoratës të zhvillohen me kohë të plotë pranë njësisë/ve bazë ose me kohë të zgjatur në ato raste kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një institucion tjetër të arsimit të lartë, apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.  
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diploma e gradës shkencore “Doktor” në “Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm”, në Fakultetin e Ekonomisë, në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër, referuar nivelit 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Aktivizimi i programit të studimit të ciklit të tretë “Doktoratë” në “Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm”, në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër, fillon pas plotësimit të rekomandimeve të lëna nga ekspertët, brenda njëzet e katër muajve, në bazë të legjislacionit në fuqi.  
Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër të marrë masa për plotësimin e rekomandimeve të mëposhtme:
  - a) Të përcaktohet qëllimi i programit për formimin e kërkuesve shkencorë dhe ekspertëve me njohuri të thelluara në fushën e kërkimit të programit të studimit që do të kontribuojnë në rekomandime të rëndësishme për sektorët ekonomikë të lidhur me Ekonominë dhe turizmin e Qëndrueshëm. Qëllimi dhe objektivat të vendosen të seksioni i përshkrimit.

- b) Të evidentohet qartë grupi i profesorëve që kanë kërkime shkencore dhe ekspertizë specifikisht në fushën e turizmit të qëndrueshëm, që do të mbështesin zhvillimin e programit dhe udhëheqjet e doktorantëve.
  - c) Të përfshihet në të dhënat e studimit të tregut specifikisht nevoja për studime në aspektin e turizmit të qëndrueshëm, si rrjedhim i studimit të bërë në projektin Erasmus+ dhe të mos vendosen studimet e palidhura me programin e doktoratës.
  - d) Të hartohet një model për paraqitjen e projekt propozimit të kandidatit që aplikon në këtë program studimi.
  - e) Të përcaktohet më qartë roli i aktiviteteve të parashikuara gjatë vitit të parë të studimeve të doktoratës dhe detyrimet e studentëve për ti ndjekur ato si dhe sasia e krediteve që studenti duhet të marrë nëpërmjet shlyerjes së tyre.
  - f) Të rishikohet (në një numër më të vogël) numri i kuotave të propozuara nga njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi duke qenë në përputhje me numrin e personelit akademik të kategorisë profesor që lidhet specifikisht me fushën e studimit të programit.
  - g) Të hartohet një plan i përgjithshëm i kërkimit shkencor në Departamentin e Turizmit (jo vetëm fushat e studimit) dhe të evidentohet angazhimi për pjesëmarrje i kandidatëve për doktorantë në aktivitetet e kërkimit shkencor të njësisë bazë.
  - h) Të hartohet kalendari i aktiviteteve shkencore (konferenca, simpozium) që njësia bazë planifikon të realizojë në mbështetje të këtij programi.
3. Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër të respektojë kriteret për personelin akademik të angazhuar për programin e studimit, lidhur me numrin maksimal të udhëheqjeve që mund të kenë në të gjitha IAL-të, në varësi të titullit akademik që zotëron udhëheqësi, në bazë të legjislacionit në fuqi.
  4. Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër të marrë masa që programi i studimit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
  5. Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtatë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.
  6. Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër të ndjekë procedurat për regjistrimin e gradës shkencore “Doktor” në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë, pranë strukturës përgjegjëse kompetente.
  7. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.

8. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Agjencia e Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**Evis KUSHI**

